



Nr. 57 prot.

Tiranë, më 18.06.2018

Lënda: **Skema Pilote Rajonale e Granteve të PZHRSH – Aplikimi Nr. RDPA-1-05 “Rikonstruksion i Godinës së Kopshtit Nr. 2 dhe Sistemimi i Ambienteve të Jashtme”**

Drejtuar: **Z. Besnik DUSHAJ**  
Kryetar, Bashkia Tropojë

Për dijëni: **Z. Shpëtim QUKU**  
Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillimin Rajonal 1

I nderuar Z. DUSHAJ,

Ju falenderojmë që paraqitët një aplikim për thirrjen për aplikime në kuadër të Skemës Pilote Rajonale të Granteve të Programit për Zhvillimin Rajonal Shqipëri (PZHRSH).

Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë se aplikimi, juaj pasi është vlerësuar nga komisioni i vlerësimit, është përzgjedhur për kohësisht për të fituar një grant.

Për të vijuar më tej me përgatitjen e kontratës së grantit, duhet të plotësohen kushtet si vijon:

- Përshkrimi i projektit dhe buxheti i projektit:** Të rishikohet plotësimi i buxhetit, p.sh: nëse janë përfshirë kostot e detyrueshme si supervizimi i punimeve, testet teknike (kolaudimi) dhe kostot për vizibilitetin. Aktivitetet për vizibilitetin duhet të përshkruhen dhe të planifikohen në planin e prokurimit si dhe të buxhetohen në mënyrën e duhur. Çdo çmim për njësi i paraqitur në buxhet nëse nuk i referohet manualeve të miratuara, duhet të shoqërohet me justifikimet e nevojshme. Nëse ka kosto që nuk lejohen, duhet të hiqen nga buxheti. Për më tepër plani i prokurimit duhet të plotësohet për të paraqitur informacionin e munguar apo të ndryshohet duke korrigjuar atë ekzistues.
- Vërtetimin e **pronësisë së pasurisë së paluajtshme** ose dokumente të tjerë që verifikojnë të drejtën ligjore për përdorimin e pronës publike përkatëse.





Dokumentet e mësipërm duhet të plotësohen brenda datës **27 qershor 2018**, në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillimin Rajonal 1, e cila do të jetë pika juaj e kontaktit gjatë fazës së përgatitjes së kontratës.

Ju lutemi vini re se kjo letër nuk ju jep të drejtën për një grant. Nuk do të fitoni këtë të drejtë derisa të dyja palët, Fondacioni PZHRSH-së dhe institucioni juaj të kenë nënshkruar kontratën e grantit.

Me respekt,



Drejtore Ekzekutive i Fondacionit PZHRSH